



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/23/24

Datë: 26.11.2024

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, nenit 17, pika b) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale; neni 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH- Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe Procedurat për pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor neni 4, paragrafi 3, pika 3.2, neni 5, neni 7, neni 8, neni 10, neni 12, neni 13, neni 14, neni 15 ; në mbështetje të neni 42, neni 49 pika 4, neni 74, të Statutit të Komunës së Junikut i datës 29.09.2010, si dhe në bazë të vendimit për pëlqim nga MMPHI me Nr. 5305-2/24 i datës 05.11.2024. **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.11.2024 nxjerrë:

V E N D I M

për

Shqyrtimin publik të Projekt – “ Planit Zhvillimor Komunal të Junikut 2024-2032

Neni 1

1.1 Me këtë Vendim shpallet në Shqyrtim Publik “Projekt Plani Zhvillimor Komunal i Junikut për periudhën 2024-2032”.

Neni 2

2.1 Hapja Zyrtare e Shqyrtimit Publik dhe prezantimi i Projekt - “Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024 -2032” bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës së Junikut, 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij **Vendimi**.

2.2 Ekspozimi i Projekt – “Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024-2032” bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.

2.3 Për prezantimin e Projekt – “Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024-2032” mbahet procesverbal.

2.4 Shqyrtimi Publik i Projekt -“Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024-2032” zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.5 Shpallja e shqyrtimit Publik të Projekt – “Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024-2032” bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht në 3 (tri) gazeta të përditshme, faqen e internetit të Komunës dhe në mediat televizive – publike lokale.

Neni 3

3.1 Në Shqyrtim Publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt “Planit Zhvillimor të komunës së Junikut 2024-2032”.

3.2 Në Shqyrtimin Publik prezantohen fazat e Projekt Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut 2024-2032 si :

- Profili i Komunës,
- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese,
- Vizioni , Qëllimet dhe Objektivat,
- Koncepti i Zhvillimit, duke përfshirë të gjitha anekset.

3.3 Projekt “Plani Zhvillimor i Komunës së Junikut 2024-2032” është dokument i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 4

4.1 Projekt Plani Zhvillimor I komunës së Junikut 2024-2032 i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet me komente dhe sugjerime që paraqiten nga publiku në formë gojore gjatë diskutimeve të shënuara në procesverbal, ato me shkrim të shënuara në librin e vërejtjeve, si dhe komentet apo vërejtjet e shkruara përmes postës elektronike, brenda afatit të përcaktuar me ligj, do të përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

5.1 Shqyrtimi Publik i Projekt - “Plani Zhvillimor i Komunës së Junikut 2024-2032” organizohet nga Komuna e Junikut në suaza të kompetencave me ligj.

Neni 6

6.1 Me këtë Vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së Shqyrtimit Publik të Projekt “Plani Zhvillimor i Komunës së Junikut 2024-2032”.

Neni 7

7.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut, dhe do të shpallet në faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/24/2024;
Datë: 26.11.2024.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040 GZKR numer 28/2008) nenit 21 paragrafi 21.1 pika H të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Juniku në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur me datë 26.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

për

Caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025

- I. Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, dhe Ligjin nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 39/A, Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut cakton normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Tabela 2: Normat Tatimore sipas kategorisë së Pronës për vitin 2025.

Kategoria e Pronës	I. Normat Tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	a. 0.10%
Për njësitë bujqësore të objekteve	b. 0.10%
Për njësitë pyjore të parcelave	c. 0.10%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	d. 0.10%
Për njësitë rezidenciale të objekteve	e. 0.15%
Për njësitë komerciale të parcelave	f. 0.15%
Për njësitë komerciale të objekteve	g. 0.10%
Për njësitë industriale të parcelave	h. 0.15%
Për njësitë industriale të objekteve	i. 0.15%

Adresa:

Tel.: +386 (0) 44 270 947
<http://rks-gov.net/junik>

- II. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2025.

Me këtë vendim njoftohen:

- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Ministrisë për Financa;
- Zyrës të Tatimit në Pronë dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/25/24

Datë: 26.11. 2024

Në bazë të nenit 40.2 germa (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Junikut, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.26.11.2024, mori vendim këtë:

V E N D I M

- I. Lirohet nga pozita e anëtarit të këshillit komunal për siguri në bashkësi në Komunën e Junikut z. Arbër Gjota pasi që i njëjti për arsye personale dhe familjare ka dhënë dorëheqje.
- II. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL ,
- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të përmendurit në pikën I,
- Arkiva.





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/26/24;
Datë: 26.11.2024.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.11.2024 nxjerrë:

V E N D I M

për

plotësimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

- I. Me këtë vendim plotësohet vendi bosh në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.
- II. Anëtarja e zgjedhur për t'iu bashkuar Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është znj. Blerina Sallaj.
- III. Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i këtij anëtari janë të njëjta me detyrat, përgjegjësitë dhe mandatin e anëtarëve të tjerë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të K.K. në Komunën e Junikut.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Znj. Blerina Sallaj;
2. Kryesuesi i KKSB-së;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/27/2024;
Datë: 26.11.2024.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040 GZKR numer 28/2008) nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit për energji dhe klimë (Ligji. 04/L-016, GZRK numër 6/2011; neni 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe neni 16 paragrafi 3. Te Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Juniku në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur me datë 26.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave
për hartimin e planit komunal për energji dhe klimë:

- I. Me këtë vendim autorizohet kryetari i Komunës që të filloj procedurat për formimin e komisionit punues për hartimin e planit komunal për energji dhe klimë. / në tekstin e mëtejme (projekt) Planit/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij projekt Planit, sipas këtij vendimi është arritja e caqeve të energjisë dhe klimës në komunën e Junikut, perkrahja e menaxhimit në nivel lokal të burimeve të energjisë si dhe propozimi i mënyrave për shfrytëzimin racional të burimeve të tilla.
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Planit nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim e komunes së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Planit është e obliguar që ta hartoj në afat sa më optimal nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Sherbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2025.

Me këtë vendim njoftohen:

- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut;
- Drejtoria për Sherbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- MAPL;
- Kryetari i komunës së Junikut; dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut.





**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/28/2024;
Datë: 26.11.2024.**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 , dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040 GZKR numer 28/2008) neni 57 të Statutit të Komunës së Junikut; Kuvendi i Komunës së Juniku në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur me datë 26.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

**për fillimin e procedurave
për hartimin e planit për Trashëgimi Kulturorë 2025-2030:**

- I. Me këtë vendim autorizohet kryetari i Komunës që të filloj procedurat për formimin e komisionit punues për hartimin e planit për trashëgimi kulturorë , / në tekstin e mëtejme (projekt) Planit/.
- II. Bartëse e hartimit të (projekt) Planit nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e komunes së Junikut.
- III. Bartësja e hartimit të (projekt) Planit është e obliguar që ta hartoj në afat prej 90 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Arsimit, Kultur, Rini dhe Sport.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës .

Me këtë vendim njoftohen:

- *Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut;*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;*
- *MAPL;*
- *Kryetari i komunes së Junikut; dhe*
- *Arkivi i Komunës së Junikut.*

Kryesuesi i Kuvendit
Z. Shpejtim Gacaferi



Adresa:

Tel.: +386 (0) 44 271 947

<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/29/24

Datë: 26.11. 2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 7 paragrafi 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.11.2024 nxjerrë:

V E N D I M

për
miratimin e

Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025 dhe orari i mbajtjes se takimeve

I. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025 dhe orari i mbajtjes se takimeve /në tekstin e mëtejme Plani/.

II. Plani është dokument publik dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

III. Kuvendi i Komunës së Junikut është i obliguar që ta respektojë dhe zbatojë Planin gjatë vitit 2025.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

